Raport krahasimor për vlerësimin institucional me nxënësit, mësuesit, prindërit dhe bizneset

Shkolla Profesionale “Teknike Ekonomike” Tiranë

Viti shkollor 2025 – 2026

Shtator 2026

Tabela e përmbajtjes

Lista e Tabelave 3

Hyrje 7

Metodologjia 7

Të dhëna për pjesëmarrësit 2026 9

Rezultatet 10

- Zhvillimi i vazhduar profesional 10
- Kurrikula 11
- Marrëdhënia me biznesit 12
- Orientimi në karrierë 13
- Projektet 13
- Marketingu 14
- Gjurmimi në nivel ofruesi 16

Lista e Tabelave

Tabela 1: Numri i pyetësorëve të plotësuar për secilin target grup 9
Tabela 2: Rezultatet për treguesit e zhvillimit të vazhduar profesional 10
Tabela 3: Rezultatet për treguesit e kurrikulës 11
Tabela 4: Rezultatet për treguesit e marrëdhënieve me biznesin 12
Tabela 5: Rezultatet për treguesit e orientimit në karrierë 13
Tabela 6: Rezultatet për treguesit e projekteve 13
Tabela 7: Rezultatet për treguesit e marketingut 14
Tabela 8: Rezultatet për treguesit e gjurmimit në nivel ofruesi 16

© 2026 Swisscontact

Rreth projektit “Aftësi për Punë” (S4J)

Aftësi për Punë (S4J) është një projekt i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) i zbatuar nga Swisscontact, i cili synon të adresojë sfidat kryesore në Arsimin dhe Formimin Profesional (AFP) në Shqipëri. Që prej tetorit 2015, projekti “Aftësi për Punë” (S4J) mbështet qeverinë dhe aktorët e tjerë të interesit për të ndërtuar një sistem cilësor të AFP në Shqipëri, i frymëzuar nga modeli zviceran. Në fazën e tij të tretë (2024-2027), me theks të veçantë tek qëndrueshmëria, projekti është angazhuar në ndarjen dhe zhvillimin e mëtejshëm të njohurive dhe përvojave të përftuara në nivel sistemi, në bashkëpunim të ngushtë me shkollat partnere.

Përmbledhje ekzekutive

Vlerësimi institucional 2025–2026 në Shkollën Teknike Ekonomike Tiranë mbështetet në përgjigjet e 360 nxënësve, 29 mësuesve, 226 prindërve dhe 24 bizneseve partnere. Ky është cikli i tretë radhazi i matjes (2024, 2025, 2026), çka lejon që ecuria e treguesve të lexohet si pirje shumëvjeçare dhe jo vetëm si ndryshim nga viti në vit.

Pikat e forta

- Zhvillimi profesional i mësuesve shënon përmirësim të qëndrueshëm: përputhja e aktiviteteve të ZHVP-së me nevojat e mësuesve u rrit nga 71.4% (2024) në 82.4% (2025) dhe 93.1% (2026), ndërsa 95.8% e mësuesve raportojnë se i zbatojnë në mësimdhënie njohuritë e marra në trajnime.
- Lidhja e kurrikulës me tregun e punës forcohet: mësuesit që e kanë më të lehtë zbërthimin e kurrikulës sipas nevojave rajonale u rritën në 93.1% (nga 69.7% në 2025), dhe kënaqësia e bizneseve me njohuritë e nxënësve u rrit në mënyrë të vazhdueshme, nga 75.5% në 91.7%.
- Orientimi në karrierë arrin pothuajse të gjithë nxënësit (91.9%), me kënaqësi në rritje të vazhdueshme për cilësinë e shërbimit (60.5% → 64.3% → 71.0%).
- Shkolla i përdor gjerësisht të dhënat e gjurmimit për planin vjetor (96.6%, nga 60.7% në 2024).

Fushat që kërkojnë vëmendje

- Informimi i nxënësve për mundësitë e punësimit pas diplomimit mbetet i ulët (49.0%), ndërsa perceptimi i prindërve për orientimin në karrierë ra në 2026 (kënaqësia 76.5% → 66.0%; ndikimi në vendimmarrjen e fëmijës 75.5% → 62.3%).
- Disa tregues të marrëdhënies me biznesin ranë: bashkëpunimi në forma të ndryshme (83.4% → 58.3%), njohja e moduleve profesionale (65.2% → 45.8%) dhe vlerësimi i reputacionit të shkollës nga bizneset (96.0% → 79.2%). Me 24 biznese, secili përfaqëson rreth 4 p.p., prandaj këto ndryshime duhen lexuar me kujdes.
- Cilësia e materialeve të marketingut vlerësohet më ulët se më parë, si nga mësuesit (100% → 80.0%), ashtu edhe nga nxënësit (71.0% → 55.0%).
- Përdorimi i të dhënave të gjurmimit nga drejtuesit dhe mësuesit për procesin mësimor bie për të tretin vit radhazi (53.6% → 47.1% → 41.4%).

Lidhjet ndërmjet funksioneve

- Të dhënat e gjurmimit përdoren gjerësisht në nivel institucioni (96.6%), por gjithnjë e më pak në klasë (41.4%). Hendeku sugjeron se gjetjet e gjurmimit nuk po përkthehen ende në praktikë mësimore.
- Pjesëmarrja e nxënësve në praktikë në biznes u rrit ndjeshëm (39.3% → 61.6%), ndërsa kënaqësia e tyre me mundësitë e praktikës (74.6% → 66.9%) dhe njohja e moduleve nga bizneset ranë. Zgjerimi i praktikës duket se po ecën më shpejt se koordinimi me bizneset.

– Orientimi në karrierë arrin shumicën e nxënësve, por informacioni konkret për punësimin mbetet i dobët dhe prindërit e perceptojnë më pak ndikimin e tij: shtrirja e shërbimit është e mirë, ndërsa përmbajtja e tij është hapësira kryesore për përmirësim.

Mbi bazën e këtyre gjetjeve, raporti përfundon me pesë rekomandime për forcimin institucional (shih seksionin “Rekomandime për forcimin institucional”).

Shënim: Ndryshimet ndërmjet viteve shprehen në pikë përqindjeje (p.p.). Lidhjet ndërmjet funksioneve paraqiten si modele të vëzhguara në të dhëna, jo si marrëdhënie shkak-pasojë.

Hyrje

Ky raport paraqet gjetjet nga procesi i **Vlerësimit Institucional** të zhvilluar në **Shkollën Teknike Ekonomike Tiranë** për vitin shkollor 2025-2026. Procesi, me synim vlerësimin e cilësisë së shërbimeve të aftësimit profesional, përfshiu nxënës, mësues, prindër dhe biznese partnere, të cilët u anketuan gjatë periudhës maj-qershor 2026. Ky vit shënon realizimin e procesit për të tretin vit radhazi, duke e konsoliduar si një praktikë të qëndrueshme dhe të rëndësishme për përmirësimin e cilësisë së ofrimit të shërbimeve.

Procesi u koordinua nga Njësia e Zhvillimit (NjZH) në shkollë, e cila luan një rol kyç në monitorimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimeve. Përshkrimi i gjetjeve në raport është i organizuar sipas treguesve për secilin funksion të NJZH-së.

Ky proces vlerësues mbështetet në përvojën e vitit shkollor 2023 - 2024, ku projekti 'Aftësi për Punë' (S4J), në bashkëpunim me gjashtë shkolla partnere[1], zhvilloi katër instrumente vlerësimi (pyetësorë), të bazuar në një metodologji rigoroze dhe pjesëmarrëse. Pas pilotimit në gjashtë shkolla, instrumentet u rishikuan për të garantuar vlefshmëri, qëndrueshmëri dhe respektim të standardeve etike[2].

Metodologjia

Në kuadër të mbledhjes së informacionit që do të ushqejë analizën vjetore të performancës institucionale, në përfundim të çdo viti shkollor do të realizohet një proces vlerësimi institucional në nivel ofruesi duke përfshirë katër grupeve kryesore: nxënës, mësues, biznese dhe prindër. Ky proces synon të vlerësojë performancën institucionale, të identifikojë fushat për përmirësim dhe të informojë objektivat e planit vjetor të institucionit.

Për këtë qëllim, janë zhvilluar katër instrumente vlerësimi (pyetësor), si vijon:

Pyetësori për nxënësit synon të mbledh mendimet dhe përvojat e nxënësve për cilësinë e shërbimeve të aftësimit profesional. Fokusohet në cilësinë e mësimdhënies, praktikën profesionale, orientimin në karrierë dhe performancën e institucionit. Qëllimi është përmirësimi i programeve për të përgatitur më mirë nxënësit për tregun e punës.

Pyetësori për mësuesit synon të mbledh mendimet dhe përvojat e mësuesve për cilësinë e shërbimeve të aftësimit profesional dhe mjedisit të të nxënit. Fokusohet në zhvillimin profesional, zbërthimin e kurrikulës, projektet zhvillimore dhe dhe performancën e institucionit. Qëllimi është identifikimi i fushave për përmirësim dhe përshtatja e praktikave me nevojat e stafit dhe nxënësve.

Pyetësori për bizneset synon të mbledh perceptimet e bizneseve për cilësinë e bashkëpunimit me institucionin dhe përvojën me nxënësit gjatë praktikës profesionale. Fokusohet

[1] Hamdi Bushati, Kolin Gjoka, Kristo Isak, Shkolla Profesionale Elbasan, Shkolla Teknike Ekonomike Tirane, Tregtare.
[2] Për më shumë informacion, shih raportin Baseline i treguesve të cilësisë së Njësisë së Zhvillimit https://skillsforjobs.al/publications/baseline-i-treguesve-te-cilesise-se-njesise-se-zhvillimit/

në përgatitjen e nxënësve, përputhshmërinë e programeve të praktikës me nevojat e tregut të punës dhe mundësitë për përmirësim. Qëllimi është forcimi i bashkëpunimit dhe angazhimi cilësor i sektorit privat në proceset e aftësimit profesional.

Pyetësori për prindërit synon të mbledhë mendimet e prindërve për cilësinë e shërbimeve të aftësimit profesional. Fokusohet në komunikimin me shkollën, orientimin në karrierë të fëmijëve dhe imazhin e institucionit. Qëllimi është përmirësimi i shërbimeve për të përmbushur pritshmëritë dhe nevojat e nxënësve dhe prindërve.

Shkolla Teknike Ekonomike Tiranë

S4J Aftësi për Punë Skills for Jobs

Të dhëna për pjesëmarrësit 2026

Për vitin shkollor 2025-2026, në shkollën profesionale "Teknike Ekonomike" 360 nxënës morën pjesë në sondazh. Nga këta, 45.8% (N=165) ishin djem, 53.3% (N=192) ishin vajza dhe 0.8% (N=3) kanë preferuar të mos përgjigjen. Të shpërndarë sipas klasave, 30.1% (N=107) e të anketuarve janë në klasën e dhjetë, 44.4% (N=158) në klasën e njëmbëdhjetë, 14.0% (N=50) në klasën e dymbëdhjetë, 10.7% (N=38) në klasën e trembëdhjetë dhe 0.8% (N=3) arsim profesional pas të mesëm.

Ndërkohë, morën pjesë në anketim 29 mësues, nga ku 86.2% (N=25) janë femra dhe 13.8% (N=4) janë meshkuj. Të ndarë sipas lëndëve që japin mësim, 86.2% (N=25) japin njëkohësisht lëndë të teorisë profesionale dhe module të praktikës profesionale, 10.3% (N=3) japin module të praktikës profesionale dhe 3.4% (N=1) lëndë të teorisë profesionale.

Në sondazhin për bizneset partnere të shkollës kanë marrë pjesë 24 biznese, nga ku të gjitha bizneset kanë pritur nxënës nga shkolla profesionale për zhvillimin e praktikës profesionale. 41.7% (N=10) operojnë në sektorin e Kontabilitet / Financë; 12.5% (N=3) në sektorin Hoteleri-Turizëm; 8.3% në sektorët Agjenci Turistike, Sigurime dhe Tregti dhe 4.2% prej tyre në sektorë të tjerë si Agroturizëm, Bar-Restorant, Menaxhim Biznesi, Prodhim / Përpunim dhe Shërbime.

Për vitin shkollor 2025-2026 në shkollën profesionale "Teknike Ekonomike" janë anketuar 226 prindër. Nga këta 21.7% (N=49) ishin meshkuj, 76.1% (N=172) ishin femra dhe 2.2% (N=5) kanë preferuar të mos përgjigjen. Të shpërndarë sipas klasën që ndjek fëmija, 35.7% (N=79) kanë pohuar se fëmija e tyre ndjek klasën e dhjetë, 43.9% (N=97) klasën e njëmbëdhjetë, 13.1% (N=29) në klasën e dymbëdhjetë, 6.8% (N=15) në klasën e trembëdhjetë dhe 0.5% (N=1) arsim profesional pas të mesmes.

Tabela 1: Numri i pyetësorëve të plotësuar për secilin target grup

Përfituesit	2024	2025	2026
Nxënës	360	565	360
Mësues	28	34	29
Prindër	268	224	226
Biznese	49	25	24

Rezultatet

Seksionet më poshtë përmbledhin rezultatet e matjeve me nxënësit, mësuesit, prindërit dhe bizneset.

Zhvillimi i vazhduar profesional

Rezultatet e tabelës 2 tregojnë një ecuri përgjithësisht pozitive të ndikimit të aktiviteteve të zhvillimit profesional (ZHVP) gjatë periudhës 2024–2026, megjithëse me ndryshime ndërmjet treguesve. Për mësuesit si përfitues të drejtpërdrejtë, vërehet një përmirësim i dukshëm në përputhjen e aktiviteteve të ZHVP-së me nevojat e tyre, nga 71.4% në vitin 2024 në 93.1% në vitin 2026, si dhe një rritje e konsiderueshme në zbatimin në mësimdhënie të njohurive dhe metodave të përfituara nga trajnimet, nga 73.1% në 95.8%. Nga ana tjetër, aftësitë e përmirësuara nga trajnimet shënojnë një rënie në vitin 2026, nga 91.2% në 82.8%, ndërsa kënaqësia me mbështetjen e marrë gjatë zbatimit të planit të ZHVP-së mbetet relativisht e qëndrueshme, rreth 89%.

Për nxënësit si përfitues indirektë, rezultatet janë më të moderuara, por tregojnë përmirësim në kënaqësinë me metodat e mësimdhënies, nga 64.7% në 66.9%, si dhe një rritje të fortë të kënaqësisë me metodat e përdorura gjatë procesit mësimor, nga 54.1% në vitin 2025 në 76% në vitin 2026. Megjithatë, kënaqësia me shpeshtësinë e ndërveprimit gjatë procesit mësimor bie nga 65.6% në 60.7% në vitin 2026.

Tabela 2: Rezultatet për treguesit e zhvillimit të vazhduar profesional

Përfitues të shërbimit	Treguesit e cilësisë	Rezultati 2024 %	Rezultati 2025 %	Rezultati 2026 %
Mësuesit e kulturës profesionale – përfitues direkt	1. Aktivitetet e ZHVP janë në përputhje me nevojat e mësuesve.	71.4	82.4	93.1
	2. Aftësitë e mësuesve janë përmirësuar nga trajnimet/aktivitetet e parashikuara në planin e ZHVP.	88.9	91.2	82.8
	3. Mësuesit janë të kënaqur me mbështetjen që kanë marrë gjatë zbatimit të planit të ZHVP.	88.9	88.2	89.7
	4. Mësuesit aplikojnë në mësimdhënie njohuritë aftësitë, shprehitë dhe metodat e reja të mësimdhënies që kanë mësuar në trajnime dhe shkëmbime.	73.1	68.8	95.8
Nxënësit – përfitues indirekt	1. Nxënësit janë të kënaqur me metodat e mësimdhënies (si p.sh., puna në grup, puna me projekte, përdorimi i teknologjisë, ndërveprimi në klasë etj.).	64.7	65.3	66.9
	2. Nxënësit janë të kënaqur me metodat e përdorura gjatë procesit të mësimdhënies.	n/a	54.1	76

	3. Nxënësit janë të kënaqur me shpeshtësinë e ndërveprimit gjatë procesit mësimor.	57.6	65.6	60.7

Kurrikula

Rezultatet për treguesit e kurrikulës paraqesin një tendencë përgjithësisht pozitive gjatë periudhës 2024–2026, me përmirësimin më të dukshëm të evidentuar në vitin 2026. Për mësuesit si përfitues të drejtpërdrejtë, lehtësia në zbërthimin e kurrikulës në përputhje me nevojat rajonale të tregut të punës është rritur ndjeshëm, nga 67.9% në vitin 2024 dhe 69.7% në vitin 2025, në 93.1% në vitin 2026. Edhe kënaqësia e mësuesve me mbështetjen e marrë nga koordinatori i kurrikulës mbetet në nivele të larta, duke arritur 93.1% në vitin 2026, pas një rënieje nga 96.4% në 2024 në 85.3% në 2025.

Në nivelin e nxënësve, perceptimi se programi mësimor është i përshtatur me tregun e punës është përmirësuar në 78% në vitin 2026, krahasuar me 73.2% në 2024 dhe 71.9% në 2025.

Një përmirësim i qëndrueshëm vërehet gjithashtu te bizneset, ku kënaqësia me njohuritë, aftësitë dhe shprehitë e nxënësve është rritur nga 75.5% në 2024 në 91.7% në 2026, ndërsa vlerësimi për përshtatjen e planeve të praktikës profesionale me nevojat e bizneseve është rritur gradualisht nga 73.5% në 78.3%. Në tërësi, rezultatet e vitit 2026 tregojnë një përmirësim të dukshëm të lidhjes ndërmjet kurrikulës, procesit mësimor dhe kërkesave të tregut të punës, veçanërisht nga këndvështrimi i mësuesve dhe bizneseve.

Tabela 3: Rezultatet për treguesit e kurrikulës

Përfitues të shërbimit	Treguesit e cilësisë	Rezultati 2024 %	Rezultati 2025 %	Rezultati 2026 %
Mësuesit – përfitues direkt	1. Mësuesit e kanë më të lehtë zbërthimin e kurrikulës në përputhet me nevojat rajonale të tregut të punës.	67.9	69.7	93.1
	2. Mësuesit janë të kënaqur me mbështetjen që kanë marrë nga koordinatori i kurrikulës për zbatimin e mësimdhënies	96.4	85.3	93.1
Nxënësit – përfitues indirekt	1. Nxënësit mendojnë se programi mësimor është e përshtatur me tregun e punës.	73.2	71.9	78.0
Bizneset – përfitues indirekt	1. Bizneset janë të kënaqur me njohuritë, aftësitë dhe shprehitë që kanë marrë nxënësit në shkollë.	75.5	84.0	91.7
	2. Bizneset mendojnë se planet e praktikës profesionale janë në përshtatje me nevojat e tyre.	73.5	76.0	78.3

Marrëdhënia me biznesit

Rezultatet tregojnë një ecuri të përzier në marrëdhëniet me biznesin. Pjesëmarrja e nxënësve në praktikë profesionale u rrit ndjeshëm në vitin 2026, në 61.6%, ndërsa kënaqësia e tyre me mundësitë dhe realizimin e praktikës ra lehtë krahasuar me vitin 2025. Nga ana e bizneseve, vlerësimi për cilësinë e përgatitjes së nxënësve u rrit në 91.7% dhe kënaqësia me bashkëpunimin me shkollën arriti në 83.3%. Megjithatë, disa tregues të bashkëpunimit dhe njohjes së ofertës profesionale të shkollës shënuan rënie në vitin 2026.

Tabela 4: Rezultatet për treguesit e marrëdhënieve me biznesin

Përfitues të shërbimit	Treguesit e cilësisë	Rezultati 2024 %	Rezultati 2025 %	Rezultati 2026 %
Nxënësit – përfitues direkt	1. % e nxënësve që kanë bërë praktikë profesionale në biznes.	44.7	39.3	61.6
	2. Niveli i kënaqësisë së nxënësve me mundësitë që ofron shkolla për praktikë profesionale në biznes.	70.3	74.6	66.9
	3. Niveli i kënaqësisë së nxënësve me realizimin e praktikës profesionale në biznes sipas planit të praktikës.	64.7	74.6	65.5
Bizneset – përfitues direkt	1. Bizneset bashkëpunojnë në forma të ndryshme me shkollën.	63.3	83.4	58.3
	2. Bizneset janë të kënaqura për bashkëpunimin me shkollën.	73.7	77.8	83.3
	3. Bizneset bashkëpunojnë ngushtë me shkollën.	22.4	44.0	37.5
	4. Bizneset janë të kënaqur me cilësinë e përgatitjes së nxënësve nga shkolla.	81.3	84.0	91.7
	5. Bizneset mendojnë se shkolla përmbush nevojat e biznesit për aftësi cilësore pune.	77.6	91.7	87.5
	6. Biznesi njeh programin mësimor që ofron shkolla.	51.0	79.2	70.8
	7. Biznesi njeh shumë mirë modulet profesionale qe ofron shkolla.	53.1	65.2	45.8

Orientimi në karrierë

Rezultatet për orientimin në karrierë tregojnë përmirësim të dukshëm te nxënësit, veçanërisht në marrjen e shërbimeve të orientimit, që u rrit nga 78.3% në 2024 në 91.9% në 2026, si dhe në kënaqësinë me cilësinë e tyre, nga 60.5% në 71%. Megjithatë, informimi për mundësitë e punësimit mbetet relativisht i ulët, në 49% në 2026. Ndërkohë, perceptimi i prindërve ka shënuar rënie krahasuar me vitin 2025, si për kënaqësinë me shërbimin e orientimit në karrierë, ashtu edhe për ndikimin e tij në vendimmarrjen e fëmijëve.

Tabela 5: Rezultatet për treguesit e orientimit në karrierë

Përfitues të shërbimit	Treguesit e cilësisë	Rezultati 2024 %	Rezultati 2025 %	Rezultati 2026 %
Nxënësit – përfitues direkt	1. Nxënësit kanë marrë shërbime të ndryshme për orientimin në karrierë.	78.3	89.1	91.9
	2. Nxënësit janë të kënaqur me cilësinë e shërbimit të ofruar në sesionet e orientimit në karrierë.	60.5	64.3	71.0
	3. Nxënësit janë të informuar për shanset e punësimit pas diplomimit në profilin që po studiojnë.	58.1	44.2	49.0
Prindërit – përfitues indirekt	1. Prindërit janë të kënaqur me shërbimin për orientim në karrierë që i jep shkolla fëmijës.	67.7	76.5	66.0
	2. Prindërit besojnë se orientimi në karrierë e ka ndihmuar fëmijën për të marrë vendimet e duhura për karrierën.	69.7	75.5	62.3

Projektet

Rezultatet për treguesit e projekteve tregojnë një përmirësim të përgjithshëm në vitin 2026 krahasuar me vitet 2024 dhe 2025. Njohja e projekteve nga mësuesit ka qenë e lartë gjatë gjithë periudhës, nga 92.9% në 2024, me një rënie në 87.9% në 2025, dhe më pas një rritje në 96.6% në 2026. Po kështu, përqindja e mësuesve që vlerësojnë se projektet përmirësojnë cilësinë e arsimit ra nga 85.7% në 2024 në 79.4% në 2025, por u rrit në 89.7% në 2026.

Përfshirja e mësuesve në hartimin e projekteve u rrit nga 21.4% në 2024 dhe 23.5% në 2025, në 41.4% në 2026. Te nxënësit, njohja e projekteve u rrit gradualisht nga 59.7% në 2024 në 65.1% në 2025 dhe 67.5% në 2026, ndërsa përfshirja në projekte mbeti pothuajse e qëndrueshme, rreth 33-34%. Kënaqësia e nxënësve me aktivitetet e projekteve ra nga 64.4% në 2024 në 57.1% në 2025, por u

rikuperua në 60.0% në 2026. Përmirësimi më i madh vërehet në kënaqësinë me rezultatet e projekteve, e cila u rrit nga 67.6% në 2024 dhe 62.5% në 2025, në 83.5% në 2026.

Tabela 6: Rezultatet për treguesit e projekteve

Përfitues të shërbimit	Treguesit e cilësisë	Rezultati 2024 %	Rezultati 2025 %	Rezultati 2026 %
Mësuesit – përfitues direkt	1. Mësuesit i njohin projektet zhvillimore të shkollës	92.9	87.9	96.6
	2. Mësuesit mendojnë se projektet zhvillimore të shkollës përmirësojnë cilësinë e arsimit	85.7	79.4	89.7
	3. Mësuesit janë të përfshirë në shkrimin e projekteve zhvillimore si pjesë e grupeve të punës	21.4	23.5	41.4
	4. Mësuesit janë të përfshirë zbatimin e projekteve zhvillimore.	21.4	14.7	
Nxënësit – përfitues direkt	1. Nxënësit janë të dijeni të projekteve zhvillimore në shkollë.	59.7	65.1	67.5
	2. Nxënësit janë të përfshirë në projekte zhvillimore	32.8	34.2	34.3
	3. Nxënësit janë të kënaqur me përfshirjen në aktivitete të projekteve të zhvilluara nga shkolla.	64.4	57.1	60.0
	4. Nxënësit janë të kënaqur me rezultatet e projekteve të zbatuara nga shkolla.	67.6	62.5	83.5

Marketingu

Rezultatet për treguesit e marketingut paraqesin luhatje të dukshme gjatë periudhës 2024-2026. Te mësuesit, kënaqësia me aktivitetet e marketingut u rrit nga 89.3% në 2024 në 93.8% në 2025, duke mbetur e lartë në 92.9% në 2026. Vlerësimi për cilësinë e materialeve informuese ra nga 96.0% në 2024 dhe 100% në 2025, në 80.0% në 2026. Ndërkohë, perceptimi për imazhin e shkollës mbeti relativisht i qëndrueshëm, rreth 93%, ndërsa përfshirja e mësuesve në aktivitetet e marketingut ra nga 60.7% në 2024 në 35.3% në 2025, duke u rikuperuar pjesërisht në 41.4% në 2026. Te nxënësit,

kënaqësia me aktivitetet e marketingut u rrit në 64.3% në 2026, por vlerësimi për cilësinë e informacionit ra në 55%. Perceptimi i bizneseve për reputacionin e shkollës u ul ndjeshëm nga 93.9% në 2024 dhe 96.0% në 2025, në 79.2% në 2026, ndërsa edhe vlerësimi i prindërve shënoi rënie, nga 75.2% në 2025 në 69.1% në 2026.

Tabela 7: Rezultatet për treguesit e marketingut

Përfitues të shërbimit	Treguesit e cilësisë	Rezultati 2024 %	Rezultati 2025 %	Rezultati 2026 %
Mësuesit – përfitues indirekt	1. Mësuesit janë të kënaqur me aktivitetet e planit të marketingut të shkollës.	89.3	93.8	92.9
	2. Mësuesit mendojnë se materialet informuese për marketingun janë cilësore	96.0	100	80.0
	3. Mësuesit janë të kënaqur me imazhi që ka shkollë	92.9	94.1	92.9
	4. Mësuesit ndihen të përfshirë në aktivitetet e marketingut të shkollës.	60.7	35.3	41.4
Nxënësit – përfitues indirekt	1. Nxënësit janë të kënaqur me aktivitetet e marketingut të shkollës	57.7	53.2	64.3
	2. Nxënësit mendojnë se informacioni i dhënë në materialet e marketingut është cilësor.	75.2	71.0	55.0
	3. Nxënësit janë të kënaqur me imazhit të shkollës.	64.4	58.2	63.2
	4. Nxënësit ndihen të përfshirë në aktivitetet e marketingut.	19.0	22.1	20.3
Bizneset – përfitues indirekt	1. Bizneset e vlerësojnë shkollën si institucion me reputacion/ imazh të mirë.	93.9	96.0	79.2
Prindërit – përfitues indirekt	1. Prindërit e nxënësve të shkollës dhe nxënësve të klasave të 8-9 vlerësojnë shkollën si institucion me imazh të mirë.	73.8	75.2	69.1

Gjurmimi në nivel ofruesi

Rezultatet për gjurmimin në nivel ofruesi tregojnë dy tendenca të kundërta gjatë viteve 2024–2026. Përdorimi i të dhënave të gjurmimit nga drejtuesit dhe mësuesit për përmirësimin e procesit mësimor ka rënë në mënyrë të vazhdueshme, nga 53.6% në 2024 në 47.1% në 2025 dhe 41.4% në 2026. Në të kundërt, përdorimi i të dhënave të gjurmimit nga shkolla për përmirësimin e aktivitetit vjetor është rritur ndjeshëm, nga 60.7% në 2024 në 88.2% në 2025 dhe 96.6% në 2026.

Tabela 8: Rezultatet për treguesit e gjurmimit në nivel ofruesi

Përfitues të shërbimit	Treguesit e cilësisë	Rezultati 2024 %	Rezultati 2025 %	Rezultati 2026 %
Drejtuesi dhe Mësuesit – përfitues direkt	1. Drejtuesit dhe mësuesit përdorin të dhënat e gjurmimit për të përmirësuar procesin mësimor dhe aktivitetet e lidhura me të.	53.6	47.1	41.4
	2. Shkolla i përdor të dhënat e gjurmimit për përmirësimin e aktivitetit vjetor	60.7	88.2	96.6

Rekomandime për forcimin institucional

Rekomandimet e mëposhtme rrjedhin drejtpërdrejt nga gjetjet e këtij raporti dhe synojnë të ushqejnë planin vjetor të shkollës për vitin 2026–2027. Secili rekomandim shoqërohet me gjetjen mbi të cilën mbështetet.

1. Orientimi në karrierë: nga shtrirja te përmbajtja

Sesionet e orientimit të pasurohen me informacion konkret për mundësitë e punësimit sipas profilit, duke përfshirë biznese partnere dhe ish-nxënës të diplomuar, si dhe me një takim të posaçëm për prindërit.

> **Gjetja:** 91.9% e nxënësve marrin shërbime orientimi, por vetëm 49.0% ndihen të informuar për shanset e punësimit pas diplomimit. Kënaqësia e prindërve me orientimin ra nga 76.5% në 66.0%, dhe besimi se ai ndihmon vendimmarrjen e fëmijës nga 75.5% në 62.3%.

2. Njohja e ofertës profesionale nga bizneset partnere

Shkolla të përgatisë për bizneset partnere një fletë informuese për çdo profil, me modulet që ofron, dhe të organizojë një takim vjetor për të prezantuar ofertën dhe për të dëgjuar nevojat e tyre.

> **Gjetja:** Njohja shumë e mirë e moduleve profesionale nga bizneset ra nga 65.2% në 45.8%, bashkëpunimi në forma të ndryshme nga 83.4% në 58.3% dhe vlerësimi i reputacionit të shkollës nga 96.0% në 79.2%. Me 24 biznese, çdo biznes përfaqëson rreth 4 p.p., prandaj prirja duhet konfirmuar në ciklin e ardhshëm.

3. Cilësia e praktikës krahas zgjerimit të saj

Planet e praktikës të rishikohen bashkë me bizneset pritëse, dhe pas çdo periudhe praktike të mblidhet një vlerësim i shkurtër nga nxënësit.

> **Gjetja:** Pjesëmarrja e nxënësve në praktikë në biznes u rrit nga 39.3% në 61.6%, ndërsa kënaqësia me mundësitë e praktikës ra nga 74.6% në 66.9% dhe me realizimin sipas planit nga 74.6% në 65.5%.

4. Të dhënat e gjurmimit në klasë

Rezultatet e gjurmimit të prezantohen çdo vit para ekipeve mësimore të çdo profili, dhe secili ekip të përcaktojë të paktën një ndryshim konkret në mësimdhënie.

> **Gjetja:** Shkolla i përdor të dhënat e gjurmimit për planin vjetor (96.6%), por përdorimi i tyre nga drejtuesit dhe mësuesit për procesin mësimor ka rënë për tre vite radhazi (53.6% → 47.1% → 41.4%).

5. Materiale marketingu të testuara me nxënës dhe mësues

Materialet promovuese të rishikohen para publikimit me një grup nxënësish dhe mësuesish, duke rritur njëkohësisht përfshirjen e tyre në aktivitetet e marketingut.

> **Gjetja:** Vlerësimi i cilësisë së materialeve ra nga 100% në 80.0% te mësuesit dhe nga 71.0% në 55.0% te nxënësit. Vetëm 20.3% e nxënësve ndihen të përfshirë në aktivitetet e marketingut.

Shtojca

Gjetjet nga pyetesoret, viti shkollor 2025-26

Shkolla Teknike Ekonomike Tiranë

Aftësi për Punë
Skills for Jobs

Shkolla Teknike
Ekonomike Tirane_Inc